



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2021:009955

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05513043

**Ac.nr.944/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin individual Adnan Konushevci, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit D.H nga F...., Rruga “R.B”, kundër debitorëve: “V.. për A..” SH.P.K., me seli në Ferizaj, Rruga “Ahmet Kaçiku”, me numër të biznesit 79736160, M.J dhe N.B, që të dy nga Ferizaj, për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur, kundër aktvendimit PP.nr.25/21 datë 14.12.2021, të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me datën 27.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e bazuar ankesa e kreditorit D.H nga Ferizaj, Rruga “R.B”, **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj PP.nr.25/21 datë 14.12.2021, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedim të serishëm.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PP.nr.25/21 datë 14.12.2021, ka vendosur sinë vijim: *“III. PRANOHEN pjesërisht si të bazuar prapësimet e debitorëve M.J dhe N.B, të ushtruar kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.393/2020, të datës 14.12.2020, i lëshuar nga Përmbaruesi privat Mubarak Shumolli nga Ferizaj, sa i përket debitorëve M.J dhe N.B dhe për kamatën ligjore prej 8%, si dhe SHFUQIZOHET urdhri për lejimin e përmbarimit sa i përket debitorëve M.J dhe N.B dhe për kamatën ligjore prej 8%. I. REFUZOHEN si të pabazuara prapësimet e debitorëve M.J dhe N.B, të ushtruara kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.393/2020, të datës 14.12.2020, sa i përket debitorit “Vizioni për Arsim” SH.P.K dhe për shpenzimet e procedurës përmbarimore*

*dhe MBETET në fuqi urdhëri për përmbarrim vetëm sa i përket debitorit “Vizioni për Arsim” O.P dhe për shpenzimet e procedurës përmbarrimore”.*

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarrimore si dhe konstatimin e gabuar të gjendjes, duke propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit dhe të anulohet aktvendimi ankimuar në pikën -I- të dispozitivit dhe të mbetet në fuqi urdhri P.nr.393/21 i datës 14.12.2020 i përmbarruesit privat Mubarek S.Shumolli, si dhe të obligohet debitori që kreditorit t'i shpërblej dëmin për shpenzimet e procedurës dhe atë 156.00 euro sipas TOAK-së.

Përgjigje në ankesë nuk kanë parashtruar debitorët.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 19, 194 dhe 208 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e bazuar për këto arsye:

Nga shkresat e lëndës rrjedh se me urdhrin P.n.393/2020, të datës 14.12.2020, përmbarruesi privat Mubarak Shumolli nga Ferizaj, e ka caktuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori D.H, kundër debitorëve: “Vizioni për Arsim SH.P.K, me seli në Ferizaj, M.J dhe N.B, për pagesën e borxhit në shumë prej 2,875.00 euro, dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore, në bazë të aktgjykimit C.nr.379/16, të datës 23.01.2018, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj. Kundër urdhrin për lejim e përmbarrim debitori ka ushtruar prapësim me datën 23.12.2020, ndërsa kreditori me datën 30.12.2020, ka paraqitur përgjigje në prapësim. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe prapësimit vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar se pretendimet e debitorëve janë pjesërisht të bazuara, sepse në bazë të aktgjykimit C.nr.379/16, të datës 23.01.2018, në bazë të cilit edhe është nxjerrë urdhri për përmbarrim, konstatohet se me këtë aktgjykim nuk janë detyruar debitorët M.J dhe N.B që t'ia paguajnë detyrimin kreditorit D.H në shumë prej 2,850.00 euro dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, mirëpo një detyrim i tillë siç shihet në aktgjykim ekziston vetëm ndaj debitorit Kolegji “Vizioni për Arsim”, por jo edhe ndaj debitorëve. Po ashtu edhe kamata ligjore të cilën e ka kërkuar kreditori në propozimin për përmbarrim prej 8%, e të cilën e ka lejuar përmbarruesi privat, nuk figuron në aktgjykimin e përmendur më lart, respektivisht nuk është vendosur për një kamatë të tillë.

Gjykata e Apelit vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore nga neni 182, paragrafi 1, të LPK-së, si dhe nenit 3, paragrafi 5, lidhur me nenin 35, paragrafi 4 të LPP-së.

Gjykata e Apelit, gjen se gjykata e shkallës së parë, ka vendosur me aktvendimin e ankimuar ndaj një debitori “Vizioni për Arsim” SH.P.K., me nr. të biznesit 71123243, edhe pse sipas propozimit të kreditorit dhe urdhrit për përmbarim, debitori i lartcekur nuk ka të bëjë me këtë procedurë, madje edhe në ankesë kreditori e thekson se nuk ka asnjë raport juridik me debitorin e lart theksuar dhe nuk ka kërkuar kreditori që biznesi i lartcekur të jetë debitor në këtë procedurë. Ky ndryshim subjektiv i debitorit në propozim për përmbarim është bërë nga ana gjykatës së shkallës së parë pa e ndërmarr asnjë veprim paraprak, që eventualisht me propozimin e kreditorit të rregullohet në aspektin subjektiv urdhri për përmbarim. Debitor në këtë rast nga kreditori është paraqitur ish “Vizioni Për Arsim” OP, me numër të biznesit 600697017, i cili biznes është shuar me datë 15.01.2015, sipas formularit publik të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovës (ARBK), nga kreditori si debitor në propozim për përmbarim janë paraqitur edhe M.J dhe N.B, të cilët ishin pronarë/aksionarë, të lloji i biznesit me ortakëri të përgjithshme “Vizioni Për Arsim” OP, me numër të biznesit 600697017, i shuar me datën e lartcekur.

Gjykata ankimore poashtu gjen se prapësim përveç personalisht debitorit Naim Braha, në këtë rast ka paraqitur prapësim edhe debitorja Merita Jonuzi, që nuk dihet se në çfarë cilësie e ka paraqitur prapësimin, si përfaqësuese “Vizioni për Arsim” SH.P.K., apo si ish Ortake e përgjithshme tek ish “Vizioni Për Arsim” OP, sepse e njëjta ka qenë përfaqësuese dhe pronare e ish “Vizioni Për Arsim” OP, në procedurën e zhvilluar kontestimore, në të cilën procedurë debitorja e lartcekur e ka pohuar padinë, andaj edhe ka rezultuar aktgjykimi mbi bazën e pohimit C.nr.379/2016 i datës 23.01.2018, mbi të cilin është lejuar përmbarimi. Për me tepër debitorja e lartcekur si ish pronare dhe aksionare “V.. Për A..” OP, ka qenë në dijeni të plotë edhe kur është zhvilluar procedura kontestimore në këtë rast, se biznesi i lartcekur ku kjo vetë ishte pronare është shuar tri vite me herët, para se sa të vendoset me aktgjykim në procedurë kontestimore dhe po në të njëjtën datë 15.01.2015, që është shuar “Vizioni Për Arsim” OP, është hapur “Vizioni për Arsim” SH.P.K., ku e njëjta debitore është njëra nga pronarët/aksionarët së bashku me debitorin Naim Braha dhe të tjerë, sipas formularit publik të ARBK-së.

Me Ligjin Nr. 06/L -016, për Shoqëritë Tregtare, ku me nenin 53 paragrafi 1, është përcaktuar: *“Ortakët e Përgjithshëm janë individualisht dhe kolektivisht përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera kontraktuese ose ligjore të Ortakërisë së Përgjithshme. Kjo përgjegjësi është e*

*pakufizuar dhe përfshin të gjithë pasurinë dhe asetet e çfarëdo lloji që janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një Ortaku të Përgjithshëm, përveç pasurisë ose asetëve të përcaktuara në ligjin në fuqi për procedurën përmbartimore”, ndërsa me paragrafi 2, të nenit të lartcekur përcaktohet se: “Personi fizik ose juridik dhe/ose Shoqëria Tregtare, duke përfshirë Shoqërinë Tregtare, që pranohet si ortak i përgjithshëm në një Ortakëri të Përgjithshme ekzistuese, merr mbi vete përgjegjësi individuale dhe kolektive për të gjitha borxhet dhe detyrimet e Ortakërisë së Përgjithshme, duke përfshirë edhe detyrimet paraprake, në të njëjtën shkallë sikurse ortakët e përgjithshëm ekzistues”.*

Gjykata ankimore pas gjetjeve si më lart, interpretimit të dispozitave ligjore vjen në përfundim se aktvendimi i ankimuar duhet domosdo të priset dhe të kthehet në të njëjtën gjykatë në procedim të serishëm sepse i njëjti është kontradiktor për brenda vet pikave të dispozitivit për arsye se në pikën -I-, e që në aktvendim e ankimuar përshkruhet si pika -III-, është vendosur të aprovet prapësimi pjesërisht i debitorëve M.J dhe N.B, mirëpo nuk dihet në raport me këta debitor a është shfuqizuar urdhri apo vetëm është pranuar pjesërisht prapësimi sepse në pikën e njëjtë të dispozitivit shfuqizohet urdhri sa i për ketë kamatës, e cila pikë e dispozitivit për gjykatën ankimore është konfuze dhe e njëjta nuk mund të ekzaminohet mëtej. Në pikën , -II-, të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar e që është e përshkruar si pika -I-, në aktvendimin e ankimuar, është refuzuar prapësimi i debitorëve M.J dhe N.B, në raport me “Vizioni për Arsim” SH.P.K., edhe pse nga procedura e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë nuk mund të konstatohet se si ky biznesë e ka arritur subjektivitetin-cilësinë e debitorit në këtë procedurë, ndërsa në pikën e njëjtë të dispozitivit gjykata e shkallës së parë e ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor vetëm sa i për ketë “Vizioni Për Arsim” OP, i cili biznes është i shuar nga data 15.01.2015, siç edhe u vlerësua më lart. Për asnjërën prej këtyre kontradiktave në pikat e dispozitivit të aktvendimit të ankimuar nuk është arsyetuar nga gjykata e shkallës së parë se si ka ardhur deri përfundim e nxjerrjes së aktvendimit të ankimuar, prandaj dispozitvi i aktvendimit të ankimuar është kontradiktor fillimisht më vetë vetën e pastaj edhe me arsyetimin e tij.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që t’i ketë parasysh shkeljet e cekura si më lartë dhe që për evitimin e tyre lidhur çështjen në fjalë, të ndërmerr veprime përkatëse përmes të cilave fillimisht duhet ta sqaroj faktin e subjektivitetit të debitorëve në këtë procedurë, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, mund të caktoi seancë dëgjimore në mënyrë që të sqarohet përgjegjësia e debitorëve M.J dhe N.B, të cilët ishin pronarë/aksionarë, të lloji i biznesit me ortakëri të përgjithshme “Vizioni Për Arsim” OP, me numër të biznesit 600697017, i shuar me datën 15.01.2015, duke respektuar parimin e përgjegjësive konform nenit 53 të Ligjit Nr.

06/L -016, për Shoqëritë Tregtare, i cituar më lart. Krejt këto më qëllim që gjykata pastaj duke aplikuar dispozitat ligjore, të ketë mundësi që të bie një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni te plotë me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë, si dhe në harmoni plotë me nenin 160 të LPK-së.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209, pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77, të LPP-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**Ac.nr.944/22 datë 27.03.2024**

**Gjyqtari**  
Adnan Konushevci